

V E N D I M
Nr. 513, datë 24.10.2002

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË RUMANISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E KARANTINËS DHE TË MBROJTJES SË BIMËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Rumanisë për bashkëpunimin në fushën e karantinës dhe të mbrojtjes së bimëve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË RUMANISË
PËR BASHKËPUNIMIN NË KARANTINËN DHE MBROJTJEN E BIMËVE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Rumanisë, më poshtë të quajtura "Palë Kontraktuese".

Të prirura nga dëshira për të rritur bashkëpunimin bilateral në fushën e karantinës dhe mbrojtjes së bimëve;

Për të mbrojtur territoret e të dy shteteve nga futja dhe përhapja e disa sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve dhe barërave të këqia, më poshtë të quajtura "parazitë karantinorë", për të kufizuar humbjet e shkaktuara prej tyre, për të lehtësuar tregtinë reciproke dhe shkëmbimet e bimëve dhe produkteve me origjinë bimore;

Ranë dakord sa vijon:

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, përdoren termet:

- a) Bimë: bimët e gjalla dhe pjesët e gjalla të tyre, përfshirë dhe farërat (aneksi nr.1).
- b) Produkte bimore: produkte me origjinë bimore, të papërpunuara (përfshirë farat jo të përcaktuara si bimë), si dhe produktet e përpunuara, të cilat për për shkak të natyrës së tyre ose duke u transformuar mund të bartin rrezikun e përhapjes së parazitëve të dëmshëm.
- c) Objekte: materiale të ndryshme nga ato me origjinë bimore, të prirura për të fshehur dhe përhapur parazitë karantinorë.
- d) Kontroll fitosanitar: aktivitetet e ushtruara të ndërmarra për të verifikuar nëse bimët, produktet bimore, objektet dhe mjetet e transportit janë të pastra nga parazitët karantinorë.
- e) Parazitë karantinorë: organizma të dëmshëm të përcaktuar në rregullat e Palëve Kontraktuese, me rëndësi potenciale për ekonominë nacionale, që nuk janë prezent ose nëse janë prezent nuk janë të përhapur dhe janë subjekt i luftimit.

Neni 2

Bashkëpunimi i specifikuar në këtë Marrëveshje realizohet në përputhje me rregullat përkatëse që janë në fuqi në shtetin e secilës Palë Kontraktuese.

Neni 3

Palët Kontraktuese marrin përgjegjësinë të përdorin të gjitha masat e mundshme për të parandaluar transmetimin e parazitëve karantinorë nga territori i njërës Palë Kontraktuese në territorin e Palës tjetër.

Lista e parazitëve karantinorë përmendet në aneksin nr.2 dhe është pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

Organet kompetente të Palëve Kontraktuese mund të ndryshojnë ose plotësojnë listën e parazitëve karantinorë.

Ndryshimet dhe shtesat e përmendura më sipër, si dhe data e hyrjes në fuqi të tyre do t'i komunikohen organit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese në rrugë diplomatike.

Neni 4

Organet kompetente të shteteve të të dy Palëve Kontraktuese do të vrojtojnë dhe inspektojnë kulturat bujqësore, pyjet dhe sipërfaqet e papunuara, lëndët e para dhe produktet bimore gjatë transportit dhe ruajtjes për të zbuluar vatrat e infeksionit të parazitëve karantinorë, të rrezikshëm për bujqësinë dhe pyjet.

Neni 5

Për të parandaluar futjen dhe përhapjen e parazitëve karantinorë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, çdo eksport i bimëve dhe produkteve me origjinë bimore duhet të shoqërohet nga një "certifikatë fitosanitare", e përpiluar sipas modelit të dhënë në aneksin nr. 3 të kësaj Konvente dhe e lëshuar nga autoritetet e caktuara nga Palët Kontraktuese.

Certifikata fitosanitare do të vërtetojë që:

a) transporti konsiderohet në përputhje me rregullat fitosanitare në fuqi të vendit importues;

b) bimët dhe produktet me origjinë bimore të ekspozuara janë të pastra nga organizmat karantinorë të përmendur në aneksin e kësaj Marrëveshjeje, ose nga të tjerë agjentë patogjenë, dëmtues apo barëra të këqija, të specifikuara në pika shtesë.

c) vendin e origjinës së këtyre bimëve dhe produkteve me origjinë bimore.

d) trajtimet që i janë bërë produktit ose ndonjë pike tjetër shtesë të kërkuar nga importuesit.

Për produktet bimore që do të rieksportohen, do të shkruhet vendi i origjinës.

Mjetet e transportit të përdorura për lëvizjen e produkteve subjekte të inspektimit fitosanitar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese duhet të jenë të pastruara mirë dhe nëse është e nevojshme të dizinfektuara.

Neni 6

Bimët, produktet bimore, objektet, ambalazhet dhe mjetet e transportit me të cilat ato mbarten janë subjekt i kontrollit fitosanitar, në përputhje me rregullat dhe rregulloret përkatëse të Palëve Kontraktuese.

Neni 7

Certifikata fitosanitare nuk përjashton të drejtën ligjore të kryerjes së inspektimit fitosanitar nga vendi importues dhe përdorimin e masave që konsiderohen të nevojshme (refuzimin e hyrjes, dizinfektimin, luftimin e insekteve, shkatërrimin etj.).

Neni 8

Nëse gjenden parazitë karantinorë apo ka shkelje të rregullave fitosanitare, organi fitosanitar kompetent i vendit importues do të informojë menjëherë për këtë organin kompetent fitosanitar të vendit eksportues.

Neni 9

Për të parandaluar futjen e parazitëve karantinorë dhe të dëmtuesve ekonomikisht të rrezikshëm, Palët Kontraktuese kanë të drejtë:

- a) të kufizojnë importin e bimëve ose produkteve bimore, ose të kërkojnë kushte speciale për importin e tyre;
- b) të ndalojnë importin e bimëve ose/dhe produkteve bimore.

Neni 10

Palët Kontraktuese ndalojnë importin e tokës (përveç torfës) dhe përdorimin si material ambalazhues të sanës, kashtës, myshkut, lëvoreve ose të materialeve të tjera të prirura për të fshehur ose përhapur parazitët karantinorë.

Neni 11

Importimet e bimëve dhe produkteve me origjinë bimore, të adresuara për zyrat diplomatike dhe stafin e tyre të shteteve të të dy vendeve, duhet të plotësojnë kërkesat fitosanitare të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Palët Kontraktuese do të sigurojnë kontrollin fitosanitar në pikat kufitare (rrugë tokësore, detare dhe ajrore) të ngritura për importin, eksportin ose tranzitimin e bimëve ose të produkteve me origjinë bimore.

Neni 13

Të dy Palët Kontraktuese, duke njohur avantazhet e bashkëpunimit në fushën e shkencës dhe mundësinë e unifikimit, nëse është e mundur, të metodave dhe mjeteve të mbrojtjes së bimëve, do të stimulojnë këtë bashkëpunim nëpërmjet:

- a) shkëmbimit të informacionit për gjendjen fitosanitare të kulturave bujqësore dhe pyjeve, masat e përdorura për luftimin e sëmundjeve, dëmtuesve dhe barërave të këqia dhe për rezultatet e marra;
- b) shkëmbimit të ligjeve dhe rregullave për mbrojtjen e bimëve dhe karantinën fitosanitare dhe të literaturës së specialitetit, duke siguruar kështu për të dy vendet një njohje më të mirë në këtë fushë.

Neni 14

Palët Kontraktuese mund t'i sigurojnë njëra-tjetrës informacion për shfaqjen dhe përhapjen e parazitëve karantinorë, me detyrimin që asnjë nga Palët Kontraktuese nuk mund t'ia japë një vendi të tretë informacionin e marrë.

Neni 15

Palët Kontraktuese organizojnë, kurdo që të jetë e nevojshme, konsultime të përbashkëta, me qëllim zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Rendi i ditës, niveli i përfaqësimit, si dhe data e konsultimeve do të caktohen në mënyrë të përbashkët.

Secila nga Palët Kontraktuese do të mbulojë shpenzimet që rrjedhin nga pjesëmarrja e saj në këto konsultime, duke respektuar legjislacionin e saj të brendshëm.

Neni 16

Palët Kontraktuese bien dakord, që për të përmirësuar tregtinë e bimëve dhe produkteve

bimore, kontrolli fitosanitar, në territorin e shtetit të Palës eksportuese mund të kryhet bashkërisht duke përdorur rregullat e Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës dërgohen bimët dhe produktet bimore.

Vendi, kushtet dhe data e kontrolleve fitosanitare të përbashkëta caktohen bashkërisht nga Palët Kontraktuese.

Neni 17

Në rast se lindin probleme të diskutueshme gjatë interpretimit të kësaj Marrëveshjeje, të dy Palët Kontraktuese do t'i zgjidhin ato me kontakte direkte miqësore.

Neni 18

Organet kompetente të Palëve Kontraktuese për koordinimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

Për Palën Shqiptare
Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit

Për Palën Rumune
Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, organet kompetente të Palëve Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën mbi zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe, nëse është e nevojshme, mund të lidhin marrëveshje të tjera për përmbushjen e saj.

Neni 19

Kushtet e kësaj Marrëveshjeje nuk ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe në fuqi, të lidhura nga Palët Kontraktuese me shtete të tjera në këtë fushë.

Neni 20

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 60 ditë pas datës së njoftimit të fundit, me anën e të cilit Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën mbi përfundimin e procedurave të kërkuara nga legjislacioni i tyre i brendshëm për hyrjen në fuqi të saj.

Neni 21

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë 5-vjeçare. Ajo është automatikisht e vlefshme edhe për 5 vjet të tjera, nëse njëra nga Palët Kontraktuese nuk njofton Palën tjetër, të paktën, 6 muaj përpara përfundimit të periudhës përkatëse të vlefshmërisë mbi qëllimin e saj për ta anuluar atë.

Programet dhe marrëveshjet për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje mbeten ende të vlefshme.

Nënshkruar në Bukuresht në datën 6.12.1999 në dy kopje origjinale secila, në shqip, rumanisht dhe anglisht, të gjitha tekstet kanë të njëjtën vlerë.

Në rastin e diferencave në përkthim do të mbizotërojë teksti anglisht.

ANEKSI NR.1

Pjesët e gjalla të bimëve do të përfshijnë:

- frutat - në sensin botanik, me përjashtim të atyre të konservuara në ngrirje të thellë;
- perimet - me përjashtim të atyre të konservuara me ngrirje të thellë;
- tuberët, bulbat, rizomat;
- lulet e prera;
- degë me gjethe;
- pemë të prera me gjethe;

Farëra do të konsiderohen farërat në kuptimin botanik, me përjashtim të atyre që destinohen për mbjellje.

ANEKSI NR.2

Lista e parazitëve karantinorë në Ruman

Lista A 1 - Përfshirë parazitë karantinorë që nuk ekzistojnë në Europë

I – Parazitë

a) Insekte

1. *Acleris variana* (Fernald)
2. *Acleris gloverana* (Walsingham)
3. *Acrobasis pirivorella* (Matsumura)
4. *Aculops fuchsiae* Keifer
5. *Aleurocanthus spiniferus* (Quaintance)
6. *Aleurocanthus woglumi* (Ashby)
7. *Amauromyza maculosa* (Malloch)
8. *Anastrepha* spp.
 - 8.1. *Anastrepha fraterculus* (wiedermann)
 - 8.2. *Anastrepha ludens* (Loew)
 - 8.3. *Anastrepha obliqua* (Macquart)
9. *Anoplophora chinensis* (Forster)
10. *Anoplophora malasiaca* (Thomson)
11. *Anthonomus bisignifer* Schenkling
12. *Anthonomus grandis* bohemian
13. *Anthonomus quadrigibbus* Say
14. *Anthonomus signatus* say
15. *Bastrocera* spp. (nën-European)
 - 15.1. *Bastrocera cucurbitae* (Coquillett)
 - 15.2. *Bastrocera dorsalis* (Hendel)
 - 15.3. *Bastrocera minax* (Enderlein)
 - 15.4. *Bastrocera tryoni* (Froggatt)
 - 15.5. *Bastrocera tsuneonis* (Mlyake)
 - 15.6. *Bastrocera zonata* (Saunders)
16. *Blitopertha orientalis* (Waterhouse)
17. *Carposina niponensis* (Walsingham)
18. *Ceratitis cosyra* (Walker)
19. *Conotrachelus nenuphar* (Herbst)
20. *Cydia inopinata* (Heinrich)
21. *Cydia packardi* (Zeller)
22. *Cydia prunivora* (Walsh)
23. *Dacus ciliatus* Loew
24. *Epitrix tuberis* Gentner
25. *Epochra canadensis* (Loew)
26. *Euphranta japonica* (Ito)
27. *Helicoverpa zea* (Boddie)
28. *Liriomyza sativae* Blanchard
29. *Listronotus bonariensis* (Kuschel)
30. *Lopholeucaspis japonica* Cockerell
31. *Parasaissetia nigra* (Nietner)
32. *Pissodes* spp.(non -European)
 - 32.1. *Pissodes nemorensis* germar
 - 32.2. *Pissodes strobi* (Peck)
 - 32.3. *Pissodes terminalis* Hopping
33. *Popilla japonica* newman
34. *Premnotripes* spp (Andean)

35. *Rhagoletis* spp.(non -European)
- 35.1. *Rhagoletis cingulata* (Loew)
- 35.2. *Rhagoletis completa* Cresson
- 35.3. *Rhagoletis fausta* (Osten Sacken)
- 35.4. *Rhagoletis indifferens* curran
- 35.5. *Rhagoletis mendax* curran
- 35.6. *Rhagoletis pomonella* (Walsh)
- 35.7. *Rhagoletis ribicola* doane
36. *Scolytidae* (non-European)
- 36.1. *Dendroctonus adjunctus* blandford
- 36.2. *Dendroctonus brevicomis* leconte
- 36.3. *Dendroctonus frontalis* zimmermann
- 36.4. *Dendroctonus ponderosae* hopkins
- 36.5. *Dendroctonus pseudotsugae* Hopkins
- 36.6. *Dendroctonus rufipennis* (Kirby)
- 36.7. *Dryocoetes confusus* Swaine
- 36.8. *Gnathotrichus sulcatus* (Leconte)
- 36.9. *IPS calligraphus* (Germar)
- 36.10. *IPS confusus* (LeConte)
- 36.11. *IPS grondicollis* (Eichhoff)
- 36.12. *IPS lecontel* swaine
- 36.13. *IPS pini* (Say)
- 36.14. *IPS plastographus* (LeConte), with two subsp. I.P.
Plastographus (Leconte) and I.P. *maritimus* lanier
37. *Spodoptera eridania* (Cramer)
38. *Spodoptera frugiperda* (J.E.Smith)
39. *Spodoptera litura* (Fabricius)
41. *Thrips palmi* kamy
42. *Toxoptera citricidus* (Kirkaldy)

b) Nematode

1. *Bursaphelenchus xylophilus* (Seiner & Buhrer) Nickle
 2. *Heterodera glycines* Ichinohe
 3. *Nacobbus aberrans* (Thorne) Thorne & Allen
 4. *Radopholus citrophilus* Huettel et al.
- II. Agentë fitopatogjenetikë

a) Kërpudha

1. *Alternaria kikuchiana* S.Tanaka
2. *Alternaria mali* Robrts
3. *Apiosporina morbosa* (Schweinits) von Arx
4. *Atropellis* spp.
- 4.1. *Atropellis piniphila* (Weir) Lohman & Cash
- 4.2. *Atropellis pinicola* Zeller & Goodding
5. *Botryosphaeria berengeriana* de Notaris f.sp *Piricola* (Nose) Koganezawa & Sakuma
6. *Botryosphaeria larinia* (K.Sawada) Y.Zhong
7. *Ceratocystis fagacearum* (Bretz) Hunt
8. *Ceratocystis virescens* (Davidson) Moreau
9. *Chrysomyxa arctostaphyli* Dietel
10. *Ciborinia camelliae* Kohn
11. *Cronartium* spp.(non-European):
- 11.1. *Cronartium coleosporidides* J.C.Arthur
- 11.2. *Cronartium comandrae* Peck
- 11.3. *Cronartium comptoniae* J.C.Arthur
- 11.4. *Cronartium fusiforme* Hedcock & Hunt ex.Cummings

- 11.5. *Cronartium himalayense* Bagchee
- 11.6. *Cronartium kamtschaticum* Jorstad
- 11.7. *Cronartium quercuum* (Berkeley) Miyabe ex. Shirai
- 11.8. *Endocronartium harknessii* (J.P. Moore) Y. Hiratsuka
12. *Elsinoe fawcettii* Bitancourt & A.E. Jenkins
13. *Gymnosporangium* spp. (non-European)
- 13.1. *Gymnosporangium asiaticum* Miyabe ex. Yamada
- 13.2. *Gymnosporangium clavipes* (Cooke & Peck) Cooke & Peck
- 13.3. *Gymnosporangium globosum* (Farlow) Farlow
- 13.4. *Gymnosporangium juniperi-Virginianae* Schweinitz
- 13.5. *Gymnosporangium shiraianum* K. Hara
- 13.6. *Gymnosporangium yamadae* Miyabe ex. Yamada
14. *Guignardia citricarpa* (Kiely)
15. *Hamaspora longissima* (Thumen) Kornicke
16. *Inonotus weirii* (Murrill) Kotlaba & Pouzar
17. *Melampsora farlowii* (J.C. Arthur) J.J. Davis
18. *Monilinia fructicola* (Winter) Honey
19. *Mycosphaerella gibsonii* H.C. Evans
20. *Mycosphaerella laricis-Leptolepidis* K. Ito, K. Sato & M. Ota
21. *Mycosphaerella populorum* G.E. Thomson
22. *Ophiostoma wagneneri* (Goheen & Cobb) Harrington
23. *Phialophora gregata* (Allington & Chamberlain) W. Gams
24. *Phoma andina* Turkesteven
25. *Phyllosticta solitaria* Ellis & Everhart
26. *Phymatotrichopsis omnivora* (Duggar) Hennebert
27. *Puccinia pitteriana* P. Hennings
28. *Septoria lycopersici* Spegazzini var. *Malagutii* Ciccarone & Boerema
29. *Thecaphora solani* (Thirumalachar & O'Brien) Mordue
30. *Tilletia indica* Mitra
31. *Venturia nashicola* S. Tanaka & S. Yamamoto

b) Bakterie

1. Citrus greening Bacterium (without scientific name)
2. *Xanthomonas campestris* (Pammel) Dowson vegetal products Citri (Hasse) Dye 1978
3. *Xanthomonas campestris* pv. *Dieffenbachiae* (Mc. Culloch and Pirone) Dowson
4. *Xanthomonas oryzae*
- 4.1. *Xanthomonas oryzae* (ex. Ishiyama) Swings et al. pv. *Oryzae* (Ishiyama) Swings et al.
- 4.2. *Xanthomonas oryzae* (ex. Ishiyama) Swings pv. *Oryzae* (Fang et al) Swings et al.
5. *Xylella fastidiosa* Wells et al.

c) Mycoplasma

1. Elm Phloem necrosis Mlo
2. Palm Lethal yellowing Mlo
3. Peach mlos
- 3.1. Peach rosette Mlo
- 3.2. Peach X Disease Mlo
- 3.3. Peach yellows Mlo
4. Potato purple-top Wilt Mlo
5. Strawberry witches' broom Mlo

d) Viruse

1. American plum Tree Line Pattern Virus
2. Cherry little Cherry Disease
3. Cherry rasp Leaf Nepovirus
4. Citrus tatterleaf Capillovirus
5. Coconut cadang-cadang viroid
6. Peach latent Mosaic Viroid
7. Potato viruses (non-European)

- 7.1. Andean potato Latent Tymovirus
- 7.2. Andean potato Mottle Comovirus
- 7.3. Arracacha B Virus, Oca Strain
- 7.4. Potato deforming Mosaic Disease
- 7.5. Potato T Capillovirus
- 7.6. Potato yellow Dwarf Rhadovirus
- 7.7. Potato yellow Vein Disease
- 7.8. Tobacco ringspot Nepovirus, Potato Calico Strain
- 7.9. Tobacco streak virus, Potatoes Strain
8. Raspberry leaf Curl Virus
9. Strawberry latent C Disease

III. Bimë parazitore

1. *Arceuthobium* spp. (non - European):

Especially: *A. Abietinum* var. *Magnificae*

A. Americanum

A. Campylopodum

A. Cyanocarpum

A. Douglasii

A. Laricis

A. Microcarpum

A. Pusillum

A. Vaginatatum

Aneksi i listës A 1

Vectore

1. *Ceratocystis fagacearum* and its vectors
 - 1.1. *Pseudopityophthorus minutissimus* (Zimmermann)
 - 1.2. *Pseudopityophthorus pruinosus* (Eichhoff)
2. Elm phloem Necrosis Mlo and its vector;
 - 2.1. *Scaphoideus luteolus* van Duzee
3. Citrus greening Bacterium (without scientific name) and its vectors
 - 3.1. *Diaphorina citri* Kuwayana
 - 3.2. *Trioza erytreae* (Del Guercio)
4. *Bursaphelenchus xylophilus* and its vectors
 - 4.1. *Monochamus alternatus* Hope
 - 4.2. *Monochamus carolinensis* (Oliver)

Lista A 2 - Përfshirë parazitë karantinorë që ekzistojnë në Europë

I. Parazitë

a) Insekte

1. *Bemisia tabaci* (Gennadius)
2. *Bruchidius incarnatus* Boheman
3. *Cacoecimorpha pronubana* Hubner
4. *Callosobruchus chinensis* L.
5. *Callosobruchus maculatus* Fabricius
6. *Caulophilus latinasus* Say
7. *Ceratitis capitata* (Wiedemann)
8. *Diabrotica virgifera* Le Conte
9. *Epichoristodes acerblia* Walker
10. *Erllosoma lanigerum* xx) Hausm
11. *Frankliniella occidentalis* (Pergande)
12. *Gnorimoschema operculella* Zeller
13. *Liriomyza huidobrensis* (Blanchard)
14. *Opogona sacchari* (Bojer)

15. *Parabenisia myricae* (Kuwana)
16. *Quadraspidiotus perniciosus* xx (Comstock)
17. *Spodoptera littoralis* (Boisduval)
18. *Trogoderma granarium* Everts
19. *Zabrotes subfasciatus* Boh.

b) Nematode

1. *Aphelenchoides besseyi* Christie
2. *Aphelenchoides fragariae* (Ritzema-Bos) Christie
3. *Globodera pallida* (Stone) Behrens
4. *Globodera rostochiensis* (Wollenweber) Behrens
5. *Heterodera schachtii* Schmidt
6. *Meloidogyne* spp.
7. *Radopholus similis* (Cobb) Thorne
8. *Xiphinema* spp.

II- Agentē Fitopathogjenetikē

a) Kērpudha

1. *Ceratocystis fimbriata* Ellis & Halsted f.sp. *Platani* Walter
2. *Cochliobolus carbonum* R.R. Nelson
3. *Cochliobolus heterostrophus* (Drechs) Drechs
4. *Cryphonectria parasitica* (Murrill) Barr
5. *Didymella ligulicola* (K.F. Baker, Dimock & L.H. Davis) von Arx
6. *Hypoylon mammatum* (Wahlenberg) J. Miller
7. *Melampsora medusae* Thumen
8. *Mycosphaerella dearnessi* M.E. Barr
9. *Mycosphaerella linicola* Naumov
10. *Phialophora cinerescens* (Wollenweber) van Beyma
11. *Phytophthora fragariae* Hickman var. *Fragariae* Wilcox & Duncan
12. *Phytophthora fragariae* Hickman var. *Rubi* Wilcox & Duncan
13. *Phytophthora megasperma* Drechsler f.sp. *Glycines* Kuan & Erwin
14. *Puccinia horiana* P. Hennings
15. *Puccinia pelargonii* - *Zonalis* Doidge
16. *Stenocarpella macrospora* (Earle) Sutton
17. *Sternocarpella maydis* (Berkeley) Sutton
18. *Synchytrium endobioticum* (Schilbersky) Percival
19. *Uromyces transversalis* (Thumen) Winter
20. *Verticillium* x) spp.
21. *Rosellinia necatrix* (Hart) Berl
22. *Phoma lingam* (Tode) Desn

b) Bakterie

1. *Clavibacter michiganensis* (Smith) Davis et. al. subsp. *Insidiosus* (MCCulloch) Davis et al.
2. *Clavibacter michiganensis* (Smith) Davis et al. subsp. *Sepedonicus* (Spleckermann & Kottoff) Davis et al.
3. *Curtobacteriu flaccumfaciens* pv. *Flaccumfaciens* (Hedges) Collins & Jones
4. *Erwinia amylovora* (Burrill) Winslow et al.
5. *Erwinia stewartii* (Smith) Dye
6. *Erwinia chrysanthemi* Burkholder et al.
7. *Pseudomonas caryophylli* (Burkholder) Starr & Burkholder
8. *Pseudomonas solanacearum* (Smith) Smith
9. *Pseudomonas syringae* van Hall pv. *Persicae* (Prunier et al.) Young et al.
10. *Xanthomonas campestris* (Pammel) Dowson pv. *Corylina* (Miller et al.) Dye
11. *Xanthomonas campestris* (Pammel) Dowson pv. *Hyacinthi* (Wakker) Dye
12. *Xanthomonas campestris* (Pammel) Dowson pv. *Juglandis* xx (Pierce) Dye
13. *Xanthomonas campestris* pv. *Translucens* (Jones, Johnson et Reddy) Dye
14. *Xanthomonas fragariae* Kennedy & King

15. *Xanthomonas populi* (Ride) Ride & Ride
16. *Xylophilus ampelinus* (Panagopoulos) Willems et al.

c) Viruse dhe viroide

1. Arabis mosaic Nepovirus
2. Barley stripe Mosaic Hordeivirus
3. Beet leaf Curl Rhabdovirus
4. Cherry necrotic Rusty Mottle Disease
5. Chrysanthemum stunt Viroid
6. Plum pox Potyvirus
7. Tomato ringspot Nepovirus
8. Tomato spotted Wilt virus

x) hop - cuttings

xx) in nursey (including mother plantations)

Lista e parazitëve karantinorë për Shqipërinë

LISTA A

Parazitë karantinorë

Kërpudha

Cochliobolus carbonum

Deuterophoma tracheiphila

Didymella ligulicola

Glomerella gossypii

Mycosphaerella dearnessii and *Mycosphaerella pini*

Phaeoisariopsis griseola

Phialophora cinerescens

Phoma exigua var *foveata*

Phytophthora megasperma f.sp.glycines

Stenocarpella macrospora and *Stenocarpella maydis*

Synchytrium and *obioticum*

Thefla controversa

Bakterie

Clavibacter michiganensis subsp.insidiosus

Clavibacter michiganensis subsp.michiganense

Clavibacter michiganensis subsp.sepedonicus

Corynebacterium flaccumfaciens

Erwinia amylovora

Erwinia stewartii

Pseudomonas carophylli

Pseudomonas solanacearum

Pseudomonas syringae pv.persicae

Pseudomonas syringae pv.pisi

Sphoplasma citri

Xanthomonas campestris pv.phaseoli

Xanthomonas campestris pv.pruni

Xanthomonas campestris pv.vesicatoria

Xylophilus ampelinus

Viruse dhe Mlo

Grapovine flavescence doree Mlo

Peardecline Mlo

Potato stalbur Mlo

Arabic mosaic nepovirus

Beet curly top geminivirus

Cerry necrotic rusty mottle disease

Citrus tristeza closterovirus

Plum pox potyvirus
Potato spindle tuber viroid
Tomato ringspot nepovirus
Nematode
Aphelenchoides besseyi
Globodera pallida
Radopholus similis
Xiphinema americanum
Insekte
Bemisia tabaci
Cacoecimorpha pronubana
Ceratitis spp.
Cydia molesta
Franciniella accidentalis
Ips.spp.
Lhomyza spp.
Opogana sacchari
Parabemisia myricae
Parasaissetia nigra
Trogoderma granarium
Unaspis yanonensis
Viteus vitifoli
Barëra të dëmshëm
Cuscuta
Crobanche
Lista B
Parazitë të dëmshëm
Kërpudha
Tilletia spp.
Ustilago spp.
Helminthosporium
Phytophthora infestans
Spongopora subterranea
Peronospora tabacina
Phytophthora capsici
Pseudoperonospora cubensis
Colloetotrichum lindemuthianum
Plasmopara halstedii
Venturia inequalis and Venturia pirina
Taphrina deformans
Plasmopara viticola
Uncinula necator
Bakterie
Bacterium tabaci
Pseudomonas lachrymans
Agrobacterium tumefaciens
Pseudomonas savastanoi
Viruse
Potato Y virus
Citrus psorosis virus
Citrus xyloporosis virus
Nematode
Meloidogine spp.
Ditylenchus dipsaci
Parazitë

Dociostaurus marocanus
Locusta migratoria
Microtus arvalis
Ftorimea operculella
Leptinotarsa decemlineata
Acanthoscelides obtectus
Calandra spp.
Ephestia kuhniella
Heliothis spp.
Tribolium confusum
Bruchus pisorum
Aceria shehldoni
Ceroplastes ruschi
Limentria dispar
Quadraspidotus perniciosus
Diaspis pentagona
Lepidosaphes ulmi
Leucanium corni
Panonychus ulmi
Eriosoma lanigerum
Psylla mali and *P. Pyri*
Hyphantria cunea
Eriophis phleocoptes